

**BRIGADA 162 “ AGIM BAJRAMI ”**  
**( DËSHMORËT E RËNË NË KOMUNËN E KAÇANIKUT NË LUFTËN**  
**PËR ÇLIRIM NË VITIN 1998 – 1999 )**

**EKSPOZE E PUNIMIT MASTER**

**NGA:**

**ARBнора OSMANI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA “**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**PRISHTINË**

**Qershor, 2022**

BRIGADA 162 " AGIM BAJRAMI " ( DËSHMORËT E RËNË NË KOMUNËN E  
KAÇANIKUT NË LUFTËN PËR ÇLIRIM NË VITIN 1998 – 1999 )

Mentori: Prof. Ass. Dr. Arsim Sinani.

Kandidatja: Arbnora Osmani

Ky punim diplome trajton një temë shumë të rëndësishme: " Brigadën 162 " Agim Bajrami ", ( Dëshmorët e rënë në komunën e Kaçanikut në luftën për çlirim në vitin 1998-1999 )". Është bërë përpjekje maksimale që ky punim shkencor të pasqyrohet drejtë, me objektivitet, pa ndikime dhe duke implementuar metodat adekuate shkencore si: Analizën, Sintezën, Përshkrimin dhe Krahasimin. Punimi përmban informacione të ndryshme, duke filluar nga literatura e botuar, shtypi dhe revistat.

Qëllimi i punimit është që të pasqyrojmë në mënyrë më të detajuar rolin dhe rëndësinë e Brigadës 162 " Agim Bajrami ", ( Dëshmorët e rënë në komunën e Kaçanikut në luftën për Çlirim në vitin 1998-1999 )". Sërbët dhe sistemi politik, ushtarak, policor dhe strukturat e tjera të komanduara nga shteti serb, pasi vranë e masakruan shumë banor të këtij territori, ua vunë flakën shtëpive të tyre, dhe kështu pas shumë vrasjeve, torturave, akteve gjenocidale ndaj popullatës shqiptare të këtyre anëve që ishte zakon i serbëve, filloi kalavari i vuajtjeve. Në këto ditë të dhimbshme, Ushtria Çlirimtare e Kosovës pasi kishte fituar përvojë luftarake dhe ndeshet me hordhitë serbe, Ushtarët e lirisë kishin një punë të madhe e të mundimshme për tu përballuar me luftën e ashpër të armikut. Por, edhe për të mbrojtur popullsinë e cila ishte pre e pushtuesit serb dhe makinerisë shtetërore serbe.

Ky punim përbëhet nga: katër kapituj, njëzet e gjashtë nënkaptuj, konkluzionet, dokumente- fotografi dhe në fund paraqiten burimet dhe literatura. Kapitulli i Parë i punimit trajton: Formimin e Brigadës 162 “ Agim Bajrami”. Kapitulli i Dytë i punimit trajton: Betejat e Brigadës 162 “ Agim Bajrami”. Kapitulli i Tretë trajton: Dëshmorët e Brigadës 162 “ Agim Bajrami”. Dhe Kapitulli i Katërt trajton: Përfundimin e luftës, Dëshmi dhe Pasoja. Punimi përmbyllet me një përfundim konstruktiv përmes së cilës pasyrohen rezultatet e arritura gjatë studimit të kësaj teme. Pas përfundimit, punimi, përmban një shtojcë të pasur me dokumente dhe fotografi e cila e rritë edhe më shumë vlerën shkencore të punimit. Në fund paraqiten burimet arkivore, literatura, shtypi, revistat, intervistat, e që janë përdorur për realizimin e punimit në fjalë.